

Prof. Dr. Alban Ibraliu

E-mail: albanibraliu@ubt.edu.al; CV

Alban Ibraliu është diplomuar “Biolog” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës në vitin 2001. Pas studimeve ka punuar si “Kërkues Shkencor”, pranë Institutit të Kërkimeve Biologjike, Akademia e Shkencave deri në vitin 2002. Nga viti 2002 pedagog pranë Departamenti të Shkencave Agronomike, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit. Ka kryer studimet e doktoratës në Universitetin Bujqësor të Tiranës me temë “*Studimi i diversiteti gjenetik të Satureja montana në Shqipëri*”, në periudhën 2004-2008. Ka kryer studimet e Postdoktoraturës në Institutin e Përmirësimit Gjenetik, Shkencave të Farave dhe Gjenetikës së Popullatave, Universiteti i Hohenheim, Shtutgart, Gjermani në periudhën 2009-2010. Alban Ibraliu është kërkues shkencor në fushën e resurseve gjenetike dhe bimëve aromatike dhe mjekësore. Aktiviteti i kërkimit shkencor lidhet me studime në fushën e resurseve gjenetike të bimëve, studime të diversitetit gjenetik tek popullatat e bimëve mjekësore dhe aromatike, studime të diversitetit të të afërmeve të egër të bimëve të kultivuara. Ai ka organizuar dhe ka marrë pjesë në më shumë se 60 konferenca shkencore dhe është anëtar bordi editorial në disa revista shkencore. Ai është autor i teksteve universitare dhe ka publikuar më shumë se 70 artikuj shkencor, 10 prej të cilave me faktor impakti. Ka marrë pjesë dhe drejtuar më shumë se 20 projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare (FAO, USAID, UNDP, GIZ, SIDA, Biodiversity International USAID, etj). Ai ka qenë Koordinator Kombëtar për Resurset Gjenetike të Bimëve në projektin SEEDNet (2003-2011) dhe aktualisht është përfaqësues kombëtar për grupin e punës së Bimëve Aromatike dhe Mjekësore (Medicinal and Aromatic Plants-MAPS WG) në Programin e Bashkëpunimit Evropian për Resurset Gjenetike të Bimëve-ECPGR.